



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4089 prot.

Fushë-Arrëz, më 29.12.2025

VENDIM
Nr. 49, datë 26.12.2025

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE
“DARDHE-QEBIK” NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË
FUSHË-ARRËZ”

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar ; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” ; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019”, Shkresa nr. 37 Prot datë 07.10.2025 “Dërgohet plani i mbarështimit i ekonomisë pyjore “Dardhe-Qebik”, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 26.12.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz,

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore “Dardhe-Qebik” për vijimin e procedurave për miratimin e tij nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit sipas Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b.
2. *Bashkëlidhur këtij Vendimi është Relacioni shpjegues për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe-Qebik”.*
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Ky vendim u zbardh me datë **29.12.2025** dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

14 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

